



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE
KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

03.06.2023

“Zbatimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën penale, legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë profesionit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare”

ALTERNATIVA (21 x 1 pikë)

1. Sipas legjislacionit shqiptar sendet ndahen në:

- a) Sende të luajtshme dhe të paluajtshme;
- b) Sende të luajtshme, aksesore dhe të paluajtshme;
- c) Sende të luajtshme, të paluajtshme, aksesore dhe të drejta reale;
- d) Sende të trupëzuara dhe të patrupëzuara;
- e) Sende dhe të drejta reale;
- f) Sende të luajtshme, sende të paluajtshme dhe sende me të drejta reale;
- g) d) dhe e);
- h) asnjë nga alternativat e mësipërme.

Përgjigja e saktë është alternativa A

2. Bashkëpronësia ekziston kur:

- a) Dy persona kanë të drejta pronësie mbi të njëjtin send;
- b) Dy persona kanë të drejta pronësie ose të drejta reale mbi të njëjtin send;
- c) Dy ose më shumë persona kanë të drejta pronësie mbi të njëjtin send;
- d) Dy ose më shumë persona kanë të drejta pronësie ose të drejta reale mbi të njëjtin send;
- e) Dy ose më shumë persona kanë të drejta pronësie dhe të drejta të tjera reale mbi të njëjtin send;
- f) Dy ose më shumë persona kanë të drejta pronësie ose të drejta të tjera reale mbi disa sende;
- g) e) dhe f);
- h) asnjë nga alternativat e mësipërme.

Përgjigja e saktë është alternativa G

3. Marrëdhënia e detyrimit lind:

- a) Nga marrëveshja me shkrim e palëve;
- b) Nga marrëveshja noteriale mes palëve;
- c) Nga kontrata, pavarësisht formës;
- d) Nga ligji;
- e) a) dhe c);
- f) c) dhe d)
- g) b) dhe c)
- h) te gjitha mesiper

Përgjigja e saktë është alternativa F

4. Me Autoritet Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave kuptojmë:

- a) Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- b) Ministria e Financave;
- c) Ministria e Drejtësisë;
- d) Agjensia e Mbikqyrjes Financiare;
- e) Banka e Shqipërisë;
- f) Asnjëra prej alternativave më sipër;
- g) të gjitha më sipër.

Përgjigja e saktë është alternativa A

5. Kategoritë e klientëve dhe transaksioneve, ndaj të cilëve zbatohet vigjilenca e zgjeruar janë:

- a) Personat e ekspozuar politikisht;
- b) Organizatat jofitimprurëse;
- c) klientët jo rezidentë;
- d) klientët të cilët kryejnë transaksione komplekse me vlera të larta dhe të pazakonta;
- e) klientët që Autoriteti Përgjegjës kërkon që të kryhet ky proces;
- f) Personat të cilët janë në një marrëdhënie biznesi me personat e ekspozuar politikisht;
- g) asnjëra prej alternativave më sipër;
- h) të gjitha më sipër.

Përgjigja e saktë është alternativa H

6. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me vendim të:

- a) Kryeministrit
- b) Ministrit të Financave
- c) Presidentit
- d) Këshillit të Ministrave
- e) Bordit Drejtues
- f) Kryetari i Kuvendit
- g) asnjë prej alternativave më sipër
- h) të gjitha më sipër

Përgjigja e saktë është alternativa D

7. Shkaqe të pavlefshmërisë së themelimit të një shoqërie tregtare, pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (në vazhdim QKR), janë:

- a) dokumentacioni për regjistrimin fillestar të shoqërisë, sipas nenit 28, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, nuk është hartuar në formë shkresore;
- b) mungesa e zotësisë juridike për të vepruar e të gjithë themeluesve të shoqërisë;
- c) objekti i veprimtarisë së shoqërisë është në kundërshtim me ligjin;
- d) në statutin e shoqërisë nuk përcaktohen emri i shoqërisë, vlera e kontributeve të nënshkruara nga secili themelues, vlera e përgjithshme e kapitalit të nënshkruar nga të gjithë themeluesit, apo statuti nuk përmban dispozita në lidhje me objektin e shoqërisë;
- e) vlera e përgjithshme e kapitalit të shoqërisë, nënshkruar nga të gjithë themeluesit, është më e ulët se vlera e kapitalit minimal, të kërkuar për shoqërinë tregtare, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- f) kapitali i nënshkruar i shoqërive aksionare nuk është shlyer nga themeluesit përpara regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në mënyrat dhe në masën e kërkuar nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- g) alternativat c), d) dhe e);
- h) alternativat a), b), c), d), e) dhe f).

Përgjigja e saktë është alternativa H

8. Në shoqërinë komandite ortakët e kufizuar nuk mundën që:

- a) të kryejnë veprime administrimi;
- b) të kundërshtojë veprimet e administrimit të ortakut të pakufizuar;
- c) të kundërshtojë veprimet e administrimit të ortakut të pakufizuar, me përjashtim të rasteve kur ai kryen një veprim, që shkon përtej veprimtarisë të zakonshme të shoqërisë;
- d) të përballojnë humbjet e shoqërisë deri në vlerën e pjesës së tij në kapital dhe vlerën e kontributeve ende të pashlyera;
- e) të veprojnë si përfaqësues ligjor të shoqërisë komandite;
- f) asnjëra nga alternativat e mësipërme;
- g) alternativat a), c) dhe e).
- h) alternativat a) dhe d)

Përgjigja e saktë është alternativa G

9. Ndër të tjera, asambleja e përgjithshme e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është përgjegjëse për marrjen e vendimeve:

- a) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- b) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- c) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- d) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) të gjitha alternativat e mësipërme;
- h) alternativat c) dhe d);

Përgjigja e saktë është alternativa G

10. Shoqëria aksionare me ofertë private, sipas ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, nuk mund të ketë një kapital më të vogël se:

- a) 100 lekë;
- b) 100 000 lekë;
- c) 5 000 000 euro;
- d) 1 000 000 lekë;
- e) 3 500 000 lekë;
- f) 5 000 000 lekë;
- g) 10 000 000 lekë;
- h) 100 000 000 lekë.

Përgjigja e saktë është alternativa E

11. Cila është alternativa e gabuar në lidhje me emërimin si administratorë në një shoqëri aksionare, e qeverisur me sistemin me një nivel:

- a) zgjidhen për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet;
- b) nëse shoqëria emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë shoqërinë veç e veç. Statuti ose rregulloret, të miratuara nga këshilli i administrimit, mund të parashikojnë ndryshe;
- c) kanë të drejtë rizgjedhje;
- d) anëtarët e këshillit të administrimit mund ta kryejnë detyrën e administratorit për sa kohë shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit janë anëtarë të pavarur;
- e) administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas;
- f) emërohen nga Këshilli i administrimit;
- g) Këshilli i administrimit mund t'i shkarkojë administratorët në çdo kohë;
- h) administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të një shoqërie të kontrolluar dhe administratori i një shoqërie të kontrolluar nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të shoqërisë mëmë.

Përgjigja e saktë është alternativa B

12. Shoqëria me përgjegjesi të kufizuar mund të shpërndajë fitim ortakëve kur pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim;
- b) në fund të çdo viti me miratimin e pasqyrave financiare;
- c) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 2 viteve në vazhdim;
- d) me vendim asambleje ortakësh edhe pse administratorët nuk kanë lëshuar certifikatë të aftësisë pague;
- e) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 24 muajve në vazhdim;
- f) aktivet e shoqërisë mbulojnë shumicën e detyrimeve e saj dhe shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim;
- g) asnjëra nga alternativat e mësipërme;
- h) alternativat c) dhe d);

Përgjigja e saktë është alternativa A

13. Procedura e falimentimit sipas ligjit për falimentimin nuk mund të fillojë:

- a) pas prishjes së personit juridik që ende nuk është likuiduar;
- b) për shoqëritë me kapital publik ose shtetëror, të organizuara si person juridik privat;
- c) për shoqëritë e sigurimit;
- d) për institucionet jobankare, sipas parashikimeve të legjislacionit për bankat në Republikën e Shqipërisë;
- e) për fondet e investimeve të letrave me vlerë;
- f) ndaj një subjekti që kryen një shërbim publik, nëse rregullohet me një ligj të posaçëm, por subjektit i është hequr licenca;
- g) alternativat c), d) dhe e);
- h) alternativat c) dhe e).

Përgjigja e saktë është alternativa H

14. Nuk janë shpenzime administrative të procedurës së falimentimit:

- a) shpenzimet që rrjedhin nga veprimtaritë e administratorit të falimentimit në ekzekutimin e detyrave të përcaktuara në këtë ligj;
- b) shpenzimet që rrjedhin nga veprimtaritë e administratorit mbikëqyrës në ekzekutimin e detyrave të përcaktuara në këtë ligj;
- c) detyrimet e mbështetjes dhe mirëmbajtjes që rrjedhin pas fillimit të procedurave të falimentimit, kur debitori është individ;
- d) kreditë financiare ose tregtare që i janë dhënë debitorit me kërkesë të debitorit, me pëlqimin e administratorit mbikëqyrës ose me kërkesë të administratorit të falimentimit, në përputhje me këtë ligj, pasi të ketë filluar procedura e falimentimit;
- e) shumat që detyrohet debitori përmes kontratave të dyanshme që janë kryer ose miratuar nga administratori i falimentimit ose administratori mbikëqyrës pas fillimit të procedurës së falimentimit;
- f) detyrimet që rrjedhin para fillimit të procedurës së falimentimit, si rrjedhojë e pasurimit të padrejtë;
- g) detyrimet që rrjedhin pas fillimit të procedurës së falimentimit, si rrjedhojë e pasurimit të padrejtë;
- h) shpenzimet gjyqësore.

Përgjigja e saktë është alternativa F

15. Vendimet e këshillit të administrimit, te sistemi me një nivel, vlerësohen të vlefshme:

- a) Kur anëtarët janë njohur me rendin e ditës 3 ditë para mbledhjes;
- b) Kur vendimi i marrë nuk kundërshtohet nga anëtarët jo të pranishëm;
- c) Kur miratohen nga kryetari i këshillit të administrimit;
- d) Kur janë të pranishëm tre të katërtat e anëtarëve;
- e) Kur janë të pranishëm një e treta e anëtarëve;
- f) Kur janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve;
- g) Pas regjistrimit në QKB;
- h) Alternativat “a” e “b”.

Përgjigja e saktë është alternativa F

16. Dy shoqëri mund të bashkohen duke themeluar një shoqërie të re:

- a) Tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese;
- b) Procesi quhet bashkim me përthithje;
- c) Vetëm pasi të shprehet gjykata;
- d) Që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re;
- e) Edhe kur janë shoqëri kolektive;
- f) Brenda një afati prej 30 ditësh nga marrja e vendimit të bashkimit;
- g) Që do të ketë formën e shoqërisë komandite;
- h) Alternativat “a” e “d”.

Përgjigja e saktë është alternativa H

17. Likuiduesit nuk mund të shpërndajnë aktivet e mbetura përpara përfundimit të afatit:

- a) 3- mujor nga publikimi i thirrjes së dytë, drejtuar kreditorëve, për të depozituar pretendimet e tyre
- b) 6- mujor nga publikimi i thirrjes së dytë, drejtuar kreditorëve, për të depozituar pretendimet e tyre
- c) 3- mujor nga publikimi i thirrjes së parë, drejtuar kreditorëve, për të depozituar pretendimet e tyre
- d) 6- mujor nga publikimi i thirrjes së parë, drejtuar kreditorëve, për të depozituar pretendimet e tyre
- e) 12-mujor nga publikimi i thirrjes së parë, drejtuar kreditorëve, për të depozituar pretendimet e tyre
- f) 12-mujor nga publikimi i thirrjes së dytë, drejtuar kreditorëve, për të depozituar pretendimet e tyre
- g) Te gjitha mesiper
- h) h) Asnjera

Përgjigja e saktë është alternativa H

18. Kalimi i kuotave në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar në mënyrë që të jetë i vlefshëm duhet të bëhet me:

- a) Akt Noterial
- b) Në mënyrë të heshtur pa nevojën e një akti të shkruar
- c) Me kontratë me shkrim
- d) Premtim verbal
- e) Deklarate prane Ndermjetesit Ligjor
- f) E sakte përgjigja (D) dhe (E)
- g) Asnjera
- h) Te gjitha mesiper.

Përgjigja e saktë është alternativa C

19. Caktimi i ekspertëve gjatë procesit të bashkimit të shoqërive:

- a) bëhet nga ana e asamblesë së përgjithshme;
- b) bëhet nga këshilli mbikëqyrës;
- c) bëhet nga secili përfaqësues i shoqërive ose me marrëveshje mes përfaqësuesve;
- d) bëhet nga gjykata me kërkesë të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë.
- e) bëhet nga Bordi i Drejtoreve
- f) bëhet nga Drejtori i Finances
- g) (e) dhe (f)
- h) Asnjëra

Përgjigja e saktë është alternativa C

20. Cila nga alternativat e mëposhtme është e pasaktë për kriteret e administratorit të falimentimit?

Nuk mund të caktohet si administrator falimentimi personi që:

- a) ka marrëdhënie familjare ose biznesi me debitorin ose drejtorët e tij;
- b) ka marrëdhënie familjare ose biznesi me debitorin ose stafin, aksionarët ose kreditorët e tij;
- c) ka marrëdhënie familjare ose biznesi me gjykatën e falimentimit;
- d) shërben si zyrtar, drejtor, është staf ose aksionar i konkurrentëve të drejtpërdrejtë të aktivitetit të debitorit;
- e) ka falimentuar në momentin e caktimit;
- f) ka dhënë paraprakisht këshilla profesionale ndaj debitorit;
- g) nuk mund të jetë aksioner i një shoqërie tregtare, sipas legjislacionit në fuqi;
- h) nuk mund të caktohet si drejtues i një shoqërie tregtare, sipas legjislacionit në fuqi.

Përgjigja e saktë është alternativa G

21. Kur punëdhënësi lejon që persona të pakualifikuar të drejtojnë makineritë elektrike:

- a) Punëdhënësi dënohet me gjobë deri në pesëdhjetëfishin e pagës minimale mujore;
- b) Punëmarrësi dënohet me gjobë deri në pesëdhjetëfishin e pagës minimale mujore;
- c) I jepet paralajmërim me shkrim punëmarrësit;
- d) I jepet paralajmërim me shkrim punëdhënësit;
- e) Konsiderohet shkelje administrative;
- f) Konsiderohet vepër penale;
- g) Alternativat e + a;
- h) Asnjëra nga alternativat më sipër;

Përgjigja e saktë është alternativa G

PYETJE ME SHITJELLIM (4 pikë secila pyetje)

1. Si përcaktohet koncepti i tregtarit sipas përkufizimit të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar?

Përgjigje:

Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar e përkufizon tregtarin në nenin 2 të tij.

Tregtari është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm. Gjithashtu me rëndësi për konceptin e tregtarit është edhe qëllimi i fitimit nga ky aktivitet i ushtruar.

Tregtari, për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara, përgjigjet personalisht me të gjithë pasurinë e të drejtat e tij të tashme dhe të ardhshme, përfshirë pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, pronësitë industriale e intelektuale, kreditë ndaj të tretëve e çdo të drejtë apo pasuri tjetër, vlera e të cilave mund të shprehet në para.

Personi fizik, i cili ushtron një profesion të pavarur (si avokat, noter, kontabilist, mjek, inxhinier, arkitekt, artist etj.), vlerësohet tregtar, nëse një ligj i posaçëm i ngarkon këtë status.

Personi fizik, i cili ushtron veprimtari bujqësore, blegtorale, pyjore e të ngjashme, vlerësohet tregtar, nëse veprimtaria e tij përqendrohet kryesisht në përpunimin dhe shitjen e produkteve bujqësore, blegtorale, pyjore (agrobiznes).

Tregtari regjistrohet në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKB. Nga marrja e statusit të tregtarit rrjedhin detyrime si ndjekja e parimeve të ndershmërisë profesionale, mbajtja e librave, inventareve, pagimi i detyrimeve tatimore, etj. Tregtari e humbet statusin e tij kur pushon ushtrimin e veprimtarisë ose kur është i detyruar ta pushojë atë. Në një rast të tillë ai çregjistrohet nga regjistri tregtar.

2. Cilat janë rastet kur ortakut apo aksionari përjashtohet nga e drejta e votës në asamble?

Përgjigje:

Në të dyja format e shoqërisë së kapitalit rastet kur ortakut përjashtohet nga e drejta e votës janë të përcaktuara qartë dhe shteruese.

Ortakut/aksionari nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës kur në asamblenë e përgjithshme merren vendime për: 1- vlerësimin e veprimtarisë së tij; 2 - shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; 3- ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; 4 - dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Në këto raste edhe përfaqësuesi i autorizuar i ortakut/aksionarit konsiderohet në të njëjtat kushte konflikti i interesit dhe nuk mund të votojë.

3. Cilat janë efektet e procedurës së falimentimit në kontratat e punësimit?

Përgjigje:

Si rregull i përgjithshëm, fillimi i procedurës së falimentimit nuk ndikon në vazhdimin e kontratave të punës.

Administratori i falimentimit ose ai i mbikëqyrjes mund të sugjerojë përfundimin ose ndryshimin e kontratave të punës. Ndikimi i përfundimit ose ndryshimit të kontratave të punës në përgjithësi rregullohet nga legjislati i punës.

Në çdo rast, falimentimi konsiderohet si një shkak ekonomik objektiv për të përfunduar ose për të ndryshuar kontratat e punës.

Gjykata e falimentimit është kompetente për të vendosur në çdo çështje që lind si pasojë e përfundimit ose ndryshimit të kontratave të punës.

4. Një shoqëri aksionare është e përbërë nga 2 aksionarë. Shoqëria pas disa kohësh bëhet me një aksionar dhe aksionari i vetëm vendos të likuadojë shoqërinë. Shoqëria është në gjendjen e aftësisë pagueuse.

- a) Përmendni dhe shpjegoni vendimet që duhen marrë duke u bazuar në informacionin më sipër dhe procedurat që duhen kryer për këto vendime.
- b) Shpjegoni caktimin e likuiduesve në rastin e shoqërive aksionare

Përgjigje a):

- Kur numri i aksionarëve bie në një, aksionari i vetëm duhet t'i njoftojë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit zvogëlimin e numrit të aksionarëve, si dhe emrin e tij.
- Nëse aksionari i vetëm nuk e përmbush këtë detyrim, ai përgjigjet personalisht, në mënyrë të pakufizuar, për detyrimet që shoqëria ndërkohë ka marrë përsipër.
- Gjithashtu duke qënë se aksionari i vetëm vendos për të likuiduar shoqërinë dhe shoqëria është në gjendjen e aftësisë pagueuse, atëherë aksionari duhet të marr vendimin për likuidimin e shoqërisë. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Një nga vendimet që duhet regjistruar te ky regjistër është edhe vendimi për likuidimin e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Përgjigje b):

Në shoqëritë aksionare, likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues. Kreditorët të cilët në keqbesim paraqesin një kërkesë për likuidimin e shoqërisë përgjigjen në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

5. Shpjegoni se kur konsiderohet pushim kolektiv nga puna, procedurat e afatet që duhet të ndiqen për këtë qëllim, si dhe shpërblimet në rast mosrespektimit të procedurave e afateve.

Përgjigje:

Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është të paktën 10 punëmarrës për ndërmarrjet me deri në 100 punonjës, 15 për ndërmarrjet me mbi 100 deri në 200 punonjës, si dhe 20 për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës. Kur punëdhënësi parashikon të bëjë pushime kolektive nga puna, ai duhet të njoftojë me shkrim organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve. Në mungesë të saj, punëdhënësi njofton punëmarrësit e tij nëpërmjet afishimit në mënyrë të dukshme, në vendin e punës. Njoftimi duhet të përmbajë veçanërisht arsyet e pushimit nga puna, numrin e punëmarrësve që do të pushohen, numrin e punëmarrësve të punësuar normalisht, si dhe kohën gjatë së cilës është parashikuar të kryhen këto pushime. Punëdhënësi i dorëzon ministrisë përgjegjëse për punën një kopje të këtij njoftimi.

Punëdhënësi bën këshillime me organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve, me qëllim që të arrihet një marrëveshje. Në mungesë të saj, punëdhënësi u jep mundësi punëmarrësve të marrin pjesë në këshillime. Ato bëhen për marrjen e masave për të shmangur ose pakësuar pushimet kolektive nga puna dhe për të zbutur pasojat e tyre. Këshillimet bëhen për një periudhë jo më pak se 30 ditë, duke filluar nga data e njoftimit, përveç kur punëdhënësi pranon një kohëzgjatje më të madhe.

Punëdhënësi njofton, me shkrim, ministrinë përgjegjëse për punën për përfundimin e këshillimeve dhe i dërgon një kopje të këtij njoftimi palës së interesuar. Nëse palët nuk kanë rënë dakord, ministria përgjegjëse për punën i ndihmon ata të arrijnë një marrëveshje, brenda 30 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit. Ministria përgjegjëse për punën nuk mund t'i ndalojë pushimet kolektive.

Punëdhënësi njofton punëmarrësit që do të pushohen nga puna, duke respektuar afatet e njoftimit, të përcaktuara në Kodin e Punës, në varësi të kohëzgjatjes së kontratave të punës, pas përfundimit të periudhës së këshillimeve, në rastin kur kemi një marrëveshje midis palëve dhe në rastin kur ndërhyjnë ministria përgjegjëse për punën, pas përfundimit të periudhës së përcaktuar për këtë qëllim.

Punëdhënësi, që nuk respekton procedurën e pushimit kolektiv nga puna detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në gjashtë muaj pagë dëmshpërblim, i cili i shtohet pagës gjatë afatit të njoftimit ose dëmshpërblimit që merret në rast mosrespektimi të këtij afati.

Punëdhënësi duhet t'u japë përparësi në rimarrjen në punë punëmarrësve të pushuar nga puna për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësit, nëse ai punëson punëmarrës me kualifikim të krahasueshëm.

USHTRIME

Ushtrimi 1 (7 pikë)

A është pronar i një apartamenti me sipërfaqe prej 100 m², të cilin dëshiron ta shesë kundrejt vlerës prej 20,000,000 Lekë. B dëshiron të blejë apartamentin e A, por ende nuk është i sigurt nëse do të arrijë të sigurojë financim nga banka për vlerën e plotë. Për të garantuar që A nuk do t'ia shesë dikujt tjetër apartamentin, B i ofrohet A-së për të lidhur një kontratë kapari, duke i vënë në dispozicion shumën prej 10,000,000 Lekë. Palët lidhin kontratën e kaparit. Pas 1 jave A ia shet apartamentin C-së. Gjatë kësaj periudhe B ka kryer shpenzime për vlerësimin e një pasurie, të cilën do ta vendoste si kolateral në bankë.

Pyetje: A mund të mbrohet B në këtë rast dhe nëse po, çfarë mund të kërkojë nga A.

Përgjigje:

Kapari shërben si garanci për realizimin e kontratës së shitjes. Duke qenë se A nuk ka respektuar kontratën e kaparit, A ka detyrimin t'i kthejë B dyfishin e kaparit, që në rastin konkret është 20,000,000 Lekë. Veç dy fishit të kaparit, B ka të drejtë të kërkojë nga A edhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar, i cili në rastin konkret është vlera e shpenzimeve të kryera nga B për vlerësimin e pronës që do të linte si kolateral në bankë për sigurimin e financimit të kontratës së shitjes.

Ushtrimi 2 (7 pikë)

A është noter. Në zyrën e tij paraqiten B dhe C, të cilët lidhin një kontratë me vlerë 20,000 Euro.

Pyetje: A duhet A të raportojë këtë veprim? Nëse po, ku dhe brenda cilit afat?

Përgjigje:

Noteri si subjekt i ligjit për parandalimin e pastrimit të parave ka detyrimin për të raportuar në autoritetin përgjegjës, për të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 24 orëve.

Ushtrimi 3 (7 pikë)

Shoqëria kolektive X në një moment të caktuar mbetet vetëm me një ortak. Ortaku i vetëm dëshiron të vazhdojë aktivitetin.

Cilat kushte dhe çfarë procedure ndiqet në këtë rast? Në cilin rast në përfundim të kësaj procedure shoqëria vlerësohet e prishur?

Përgjigje:

Ushtrimi i aktivitetit të shoqërisë kolektive në momentin që mbetet me një ortak mund të vazhdojë në dy mënyra. Ortaku i vetëm i mbetur ka mundësinë që:

- a- të vazhdojë aktivitetin e shoqërisë kolektive si e tillë duke patur detyrimin që brenda 6 muajve nga ngjarja e faktit të mbetjes si ortak i vetëm, të marrë masat e nevojshme për ta përshtatur shoqërinë me kërkesat e ligjit 9901/2008 i ndryshuar. Kjo do të thotë që ai duhet të përfshijë në shoqërinë kolektive një apo më shumë ortakë tjetër pasi shoqëria kolektive nuk mundet të vazhdojë jetën e saj me një ortak.

- b- Të kalojë veprimtarinë tregtare të shoqërisë në fjalë në një shoqëri të themeluar rishtazi që mund të ekzistojë me ortak të vetëm, psh sh.p.k.
- c- Të kërkojë të vazhdojë aktivitetin i vetëm duke kryer regjistrimin si tregtar në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKB.

Shoqëria vlerësohet e prishur nëse veprimet e mësipërme nuk janë ndërmarrë dhe ka kaluar afati 6 muajor për ti kryer. Si e tillë shoqëria kolektive konsiderohet e prishur dhe mund të kalojë në likuidim. Kërkesa mund të ngrihet në gjykatë nga cilido person i interesuar. Gjykata konstaton prishjen e shoqërisë.

Ushtrimi 4 (7 pikë)

Personi fizik X fiton aksione në shoqërinë aksionare Y me anë të një kontrate shitblerje. Kontrata e shitblerjes është e hartuar në formë shkresore. Personi fizik nuk lejohet të regjistrojë në regjistrin e posaçëm aksionet e blera pasi kontrata e shitblerjes nuk është e hartuar me akt noterial.

A ka të drejtë shoqëria Y të kërkojë që kontrata e shitblerjes të jetë e kryer me akt noterial?

Përgjigje:

Kontrata e shitblerjes është një nga mënyrat e fitimit të aksioneve.

Kontrata e shitblerjes së aksioneve duhet të regjistrohet në regjistrin e posaçëm të aksioneve, i cili mbahet nga shoqëria.

Shoqëria aksionare Y nuk ka të drejtë të refuzojë regjistrimin e aksionarëve të rinj në bazë të kësaj kontrate shitblerje pasi sipas ligjit 9901/2008 i ndryshuar neni 117.3 nuk nevojitet forma noteriale për kontratën e shitblerjes së aksioneve dhe nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës në regjistrin e shoqërisë.

Për më tepër, konsiderohen të kryer me formë shkresore, dhe të vlefshëm për regjistrim, edhe transaksionet në formë elektronike sipas parashikimeve të ligjit nr. 9879, date 21.2.2008, “Për titujt”.

Ushtrimi 5 (7 pikë)

Gjatë procedurës së falimentimit, rezulton që kolaterali nuk është i nevojshëm për vazhdimin e veprimtarisë tregtare ose profesionale, dhe kreditori i siguar kërkon ekzekutimin e garancisë.

Kalojnë 10 ditë dhe administratori nuk ndërmerr veprime për ekzekutimin. A përbën kjo shkelje dhe çfarë veprimesh pason ky mos-veprim i administratorit?

Përgjigje:

Nga fillimi i procedurës së falimentimit ose në vijim të saj, nëse kolaterali nuk është i nevojshëm për vazhdimin e veprimtarisë tregtare ose profesionale, kreditori i siguar mund të kërkojë ekzekutimin e garancisë.

Në kuptim të Ligjit Nr.110/2016, datë 27.10.2016 ‘Për falimentimin’, nëse administratori nuk fillon ekzekutimin brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, gjykata e falimentimit mund të shkarkojë administratorin ose të vendosë një sanksion ndaj tij (neni 141).

Kështu që kalimi i afatit 10 ditor nuk përbën asnjë shkelje në kuptim të Ligjit për Falimentimin. Duhet të kalojë afati prej 15 ditësh (dhe jo 10) që mos-veprimet e administratorit të konsiderohen si shkelje dhe Gjykata e Falimentimit të mund të marrë vendimin e shkarkimit të tij ose të vendosë një sanksion ndaj tij.

Ushtrimi 6 (7 pikë)

A dhe B janë ortakë të shoqërisë “Yzzh” SHPK. A zotëron 49% të kapitalit të shoqërisë, ndërsa B zotëron 51% i cili është njëkohësisht dhe administratori dhe përfaqësuesi i vetëm i shoqërisë.

Në datën 02.02.2022 asambleja e përgjithshme do të mbledhet për të diskutuar për gjendjen financiare. Ortaku A i kërkon administratorit ti vejë në dispozicion dokumentacionin ekzistues mbi aktivitetin e shoqërisë. B i përgjigjet A duke u shprehur se dokumentacionin mund të vijë ta shqyrtojë në selinë e shoqërisë dhe më pas në datë 27.01.2022 e njofton mbi zhvillimin e mbledhjes më datë 02.02.2022. Në përfundim të mbledhjes dhe vetëm me votat e ortakut mazhoritar, Asambleja e ortakëve vendos për përjashtimin e ortakut A nga shoqëria sipas nenit 102 të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar, pasi sjelljet e këtij ortakut kanë penguar veprimtarinë normale të shoqërisë. A i drejtohet gjykatës dhe kërkon ribërjen e mbledhjes me të njëjtin rend dite, duke shfuqizuar vendimin e datës 02.02.2022 të asamblesë, pasi si ortak i minorancës duhet të ushtrojë të drejtat e tij në shoqëri. Jepni zgjidhjen tuaj mbi këtë rast.

Përgjigje:

Gjykata pranon padinë e A, pasi referuar nenit 15, 83 dhe 93 të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar, rezulton se ortakut në minorancë është njoftuar mbi mbledhjen e Asamblesë në kundërshtim me nenin 83, nuk është respektuar afati 7 ditor si edhe forma e njoftimit.

Ushtrimi 7 (7 pikë)

Shoqëria aksionare “CDE” SHA. ka dy aksionerë A që zotëron 60% të aksioneve të shoqërisë dhe B që zotëron 40% të aksioneve të shoqërisë. A-ja që është edhe Administrator i vetëm shoqërisë CDE, hap një shoqëri tjetër të quajtur FGH, me të njëjtin objekt veprimtarie sikurse edhe shoqëria CDE. Në këtë situatë aksionerët hyjnë në konflikt me njëri tjetrin pasi B-ja pretendon se për shkak të veprimtarisë konkurrese i janë çenuar interesat e tij si dhe të shoqërisë CDE. B-ja kërkon që të përjashtojë A-në, si ortak të shoqërisë pasi ka vepruar në kundërshtim me interesat e shoqërisë. - A mundet B-ja që të kërkojë përjashtimin e A-së? - Cila është procedura që duhet ndjekur prej B-së? – Si do e kishit zgjidhur ju këte rast?

Përgjigje:

Duke iu referuar dispozitave të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar, Aksionari i një shoqërie nuk mund të përjashtohet nga shoqëria duke qënë se në ligj nuk përmban asnjë dispozitë që lejon një gjë të tillë. Në këtë këndvështrim duke qënë se aksionari nuk mund të përjashtohet nuk ka asnjë procedurë për tu ndjekur nga B-ja.

Duke patur parasysh aktivitetin e A-së, B-ja si ortak në minorancë ka të drejtë t’i kërkojë A-së në cilësinë e administratorit të shoqërisë thirrjen e asamblese duke përfshirë në rend të ditës çështjet që lidhen me konstatimin e situatës së konfliktit të interesit të krijuar nga veprimtaria konkurrese e ortakut mazhoritar.

Nëse asambleja e përgjithshme, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej ortakut B nuk përfshihet në rendin e ditës, Ortaku B ka të drejtë:

- të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse Administratori A nuk përmbush kërkesat e B-së brenda 15 ditëve;
- t’i kërkojë Shoqërisë CDE blerjen e aksioneve të zotëruara prej B-së.

Ushtrimi 8 (5 pikë)

Shtetasi Y.M ushtron detyrën e administratorit në shoqërinë Epsos Sh.a. me seli në Tiranë me objekt prodhimin dhe shitjen e lodrave të drurit për fëmijë. Aksioner i kësaj shoqërie është shtetasi J.L me 70% të aksioneve, si dhe shtetasi Y.M me 30% të aksioneve. Me qëllim marrjen e lëndës së parë për prodhimin e lodrave të drurit, me kërkesën e administratorit i cili është edhe aksioner në shoqëri, asambleja e përgjithshme e aksionerëve vendos të shpallë një thirrje për të marrë oferta nga të tretët që ofrojnë dru në treg, për blerjen e 1000 m³ lëndë drusore. Administratori shpall kërkesën për oferta dhe ndër ofertat e ardhura është ajo e shoqërisë Drurino Shpk nga Fieri, e cila ofronte m³ me 140 Lek, personit fizik J.T nga Korça që ofronte m³ me 130 Lek dhe shoqërisë Kaci Shpk nga Devolli e cila ofronte m³ me 130 Lek. Ortak i vetëm i shoqërisë Kaci Shpk është njëkohësisht shtetasi Y.M, por administrator i kësaj shoqërie është shtetasi S.K. Pasi vlerëson ofertat e ardhura, Y.M vendos të pranojë ofertën e shoqërisë Kaci shpk.

Sipas mendimit tuaj, a ka elementë të veprës penale në rastin e sipërpërmendur? Nëse po, për cilën vepër penale do të mbante përgjegjësi personi përgjegjës?

Përgjigje:

Shtetasi Y.M gëzon njëkohësisht cilësinë e aksionerit dhe administratorit në shoqërinë Epsos Sh.a., si dhe është ortak i vetëm në shoqërinë Kaci Sh.p.k., ofertën e së cilës ka përzgjedhur si fituese. Duke përzgjedhur shoqërinë Kaci Sh.p.k., në të cilën është ortak i vetëm, si fituese të tenderit, megjithëse oferta e kësaj shoqërie ishte e njëjtë me atë të shoqërisë Devolli, shtetasi Y.M ka shpërdoruar kompetencat e tij si administrator i shoqërisë Epsos Sh.a., nëpërmjet favorizimit të shoqërisë Kaci në të cilën ka interesa.

Neni 164 i Kodit Penal parashikon se shpërdorimi i kompetencave nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës apo administratorët e shoqërisë me qëllim përfitimi apo për të favorizuar një shoqëri tjetër ku kanë interesa, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Ushtrimi 9 (5 pikë)

Punëdhënësi X nënshkruan një kontratë 1 vjeçare me punëmarrësin Y. 2 muaj pas përfundimit të kësaj kontrate, palët nënshkruajnë një tjetër kontratë 1 vjeçare. Sërish, 1 muaj pas përfundimit të kontratës së dytë, palët nënshkruajnë një tjetër kontratë 1 vjeçare. Në përfundim të kontratës së tretë punëdhënësi vendos të mos nënshkruajë tjetër kontratë me punëmarrësin, ndërsa ky i fundit i drejtohet gjykatës duke kërkuar shpërblimin si pasojë e zgjidhjes së kontratës me afat të pacaktuar. Cila nga palët mendoni se ka të drejtë? Argumentoni përgjigjen tuaj.

Përgjigje:

Kur ndërmjet palëve kanë qenë lidhur disa kontrata të njëpasnjëshme me afat të caktuar, për jo më pak se tre vjet, mosripërtëritja e kontratës së fundit nga punëdhënësi vlerësohet si zgjidhje e kontratës me afat të pacaktuar. Kontratat me afat të caktuar ndërmjet të njëjtave palë do të konsiderohen si të njëpasnjëshme edhe në ato raste kur ka një ndërprerje të shkurtër, jo më shumë se tre muaj, ndërmjet mbarimit të një kontrate dhe lidhjes së kontratës tjetër. Në një rast të tillë, punëmarrësi ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga punëdhënësi si pasojë e zgjidhjes së kontratës me afat të pacaktuar, pasi mes palëve janë nënshkruar 3 kontrata me afat të caktuar gjatë 3 viteve, me një ndërprerje të shkurtër jo më shumë se 3 muaj.